

**VENDIM**  
**Nr. 31, datë 18.7.2017**

**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHOQËRINË UK DURRËS  
SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujerave të ndotura”, të ndryshuar, vendimit nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujerave të ndotura”, vendimit nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujerave të ndotura”, vendimit nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujerave të ndotura” dhe vendimit nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujerave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë UK Durrës sh.a.:

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

|                     | Furnizim me ujë         | Largimi dhe përpunimi i ujerave të ndotura |
|---------------------|-------------------------|--------------------------------------------|
| Konsumator familjar | 70 lekë/m <sup>3</sup>  | 50 lekë/m <sup>3</sup>                     |
| Konsumator publik   | 120 lekë/m <sup>3</sup> | 60 lekë/m <sup>3</sup>                     |
| Konsumator privat   | 130 lekë/m <sup>3</sup> | 60 lekë/m <sup>3</sup>                     |

b) Tarifë fikse

|                     |                      |
|---------------------|----------------------|
| Konsumator familjar | 150 lekë/muaj/klient |
| Konsumator publik   | 150 lekë/muaj/klient |
| Konsumator privat   | 150 lekë/muaj/klient |

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin e plotë kalendarik, pas aplikimit të tarifave të reja:

|                                    |                   |
|------------------------------------|-------------------|
| - uji pa të ardhura (humbjet)      | 68.3%             |
| - niveli i matjes                  | 88.9%             |
| - kohëzgjatja e furnizimit         | 7.4 orë/ditë      |
| - efienca e stafit                 | 4.87p/000/lidhje  |
| - mbulimi me ujë                   | 82.1%             |
| - mbulimi me kanalizime            | 47.6%             |
| - norma e arkëtimit                | 80%               |
| - cilësia e ujit (klor + koliform) | sipas standardeve |

3. Pagesa rregullatore vjetore për UK Durrës sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.

4. Vendimi KKRR nr. 10, datë 10.2.2016, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për UK Durrës sh.a.”, shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.9.2017 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Ndriçim Shani**